

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Daja përdhunoj një 34-vjeçare, reagon Zegjineja: Ajo më tha që qëndronte me dëshirë me Bledarin
ADRESA	https://lapsi.al/daja-perdhunoi-nje-34-vjecare-reagon-zegjineja-ajo-me-tha-qe-qendronte-me-deshire-me-bledarin-i1093789
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 19:47:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 19:41:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	146887335d3a37c19b784cd39884149c344c046d79470140052073bafc9c4653
TEKSTI	42722e85906669f14e6b51495aa441a097ae9487ad22cc6b7e8083c889409329
PAMJA	716ca72a5f9f1edcab220fa8b0b05b0e3678080c00246bbc4abcde1be07d9188

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	95bb3e9d2408e19a68d4b86397d9b047eae8f6c2d6b7745f2180052dd1c8cc82
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9dbe3bb033f14c903d871b5f44056dbb0c7543241b7df3ea5dc415a83f1a9da2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon një rën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/95bb3e9d2408e19a68d4b86397d9b047eae8f6c2d6b7745f2180052dd1c8cc82

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Daja përdhunoj një 34-vjeçare, reagon Zegjineja: Ajo më tha që qëndronte me dëshirë me Bledarin

L LAPS1.AL • 15 SEPTEMBER 2026



Deputetja Zegjine Caushi ka reagu pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në fshatin Suk 2 të Roskovecit, ku daja i saj, 52-vjeçari Bledar Bakaj plagosi me drapër 67-vjeçari Enver Gremaj në banesën e këtij të fundit.

Vajza e 67-vjeçarit të plagosur, M.G, pretendoi se është përdhunuar nga daja i Zegjine Caushit, pasi ai i kishte premtuar një vend pune, me ndihmën e deputetes socialiste.

Ndërkohë Caushi ka sqaruar atë se çfarë ka ditur për marrëdhënien mes Bledar Bakajt dhe M.G.

Përmes një postimi në rrjetet sociale, Caushi thotë se i ka takuar rastësisht të dy në fillim të muajit qershor, teksa kishte kaluar pranë banesës së tyre, ku ndodheshin edhe rreth 10-15 persona të tjerë.

Sipas saj, në atë takim M.G i është prezantuar si bashkëjetuesja e Bledarit dhe ka deklaruar se e kishte marrë parasysh situatën në të cilën ai jetonte, pavarësisht kundërshtimit të babait të saj.

Deputetja thekson se ka qëndruar rreth 10 minuta dhe më pas është larguar për shkak të angazhimeve të saj, ndërsa më vonë ka parë në rrjetet sociale fotografi të çiftit së bashku.

Caushi nënvizon se për ngjarjen e ndodhur është informuar përmes mediave, njësoj si opinioni publik, dhe thekson se dënon me forcë çdo formë dhune, pavarësisht se nga kush është ushtruar.

Ajo kërkon që rasti të trajtohet me seriozitet edhe nga këndvështrimi psikologjik për të dy personat dhe që organet ligjzbatuese të bëjnë punën e tyre, me qëllim ndalimin e përshkallëzimit të konfliktit.

ide



Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Andi Bushati



Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet
Blendi Kajsiu

MOTITIRANA

21°C

KËMBIMIEURO

91.69

aktuale

28:58

Dhuna policore/ Protestuesit paralajmërojnë përshkallëzim: Do bllokojmë institucionet

08:10



Shtatori ndez protestat/ Qytetarët rikthehen në shesh, 107 ditë mobilizim kundër qeverisë



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



Reagimi i deputetes Zegjine Caushi:

Duke iu referuar ngjarjes së ndodhur në fshatin Suk 2 dhe të publikuar nga mediat më 14.09.2026 dhe 15.09.2026, dëshiroj të sqaroj opinionin publik lidhur me informacionet e dhëna deri tani.

Familja e nënës sime përbëhet nga 11 fëmijë: 9 motra dhe 2 vëllezër. Të gjithë kanë familjet, punët dhe jetët e tyre, ndaj natyrshëm nuk kemi kontakte të vazhdueshme dhe të pandërprera me njëri-tjetrin.

Vëllain e nënës, Bledar Bakaj, së bashku me znj. M.G, e kam takuar rastësisht pas një takimi që kisha në atë zonë, në fillim të muajit qershor. Kam kaluar pranë banesës dhe kam parë të afërm dhe fqinjë, rreth 10-15 veta, në oborrin e banesës. Madje, aty kam takuar edhe një kushëri, të cilin M. G e kishte njeriun e afërt nga fisi i të ëmës.

Sapo kam hyrë në oborr kam parë M, e cila m'u prezantua si bashkëjetuesja e Bledarit. I urova padyshim për lidhjen e tyre, pasi atë gjë po bënin edhe fqinjët që ishin prezent dhe më pas, si unë, edhe kushëri im iu drejtua: "E keni ndarë mendjen? Do martoheni?"

Merita Gremaj tha: "Po po, i kam marrë parasysh kushtet në të cilat Bledari jeton, edhe pse babai s'e ka me qejf..."

"Se mos na hapni probleme", iu drejtova pas fjalëve të saj, referuar pëlqimit të babait. Gjëja kaloi me të qeshura dhe urime nga njerëzit e pranishëm.

Kam ndenjur rreth 10 minuta dhe kam lëvizur për angazhimet e mia, të tjerët kanë vazhduar të qëndronin.

Pas disa ditësh, pashë edhe në rrjetet sociale, fotografi të tyre së bashku, të qeshur dhe me lule në duar.

Ky është i gjithë informacioni që kam pasur dhe kam në lidhje me marrëdhënien e tyre.

Për këtë ngjarje jam informuar përmes mediave, njësoj si opinioni publik.

Dua ta them shumë qartë: dënoj me forcë çdo formë DHUNE, pavarësisht se nga KUSH është ushtruar.

Në të njëjtën kohë, mendoj se ky është një rast që duhet të trajtohet me seriozitet e kujdes edhe nga këndvështrimi psikologjik, për të dy personat, me qëllim gjetjen e zgjidhjes së duhur dhe parandalimin e çdo përshkallëzimi të mëtejshëm.

Për pjesën tjetër, organet ligjzbatuese duhet të bëjnë punën e tyre.



Rama lëshon Ballukun/ Top Channel nis sulmin: "Pse SPAK vonon kërkesën për arrestimin"



PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane



Del një tjetër PERGJIM i Ron Yeffet: Ministrinë e Energjetikës ma lini mua



Policia reagon për kërcënimin me vdekje ndaj Osman Stafës

Të keshilluara



Sa i kushtoi Kosovës mbrojtja e të akuzuarve në Hagë?

Mbi 40.6 milionë euro janë paguar nga buxheti i Kosovës për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të ak...



Qeveria premton rritje pensionesh në prag të zgjedhjeve vendore

Qeveria njoftoi të martën se ka në plan të dyfishojë bonusin mujor për pensionistët duke nisur nga 1 janari 2027, në një kohë kur vendi bëhet gati për fushatën elektorale të zgjedhjeve vendore.



Nesër shpallet vendimi, shqiptarët mblidhen para Gjykatës Speciale në Hagë



Me 18 kg drogë, kapet shqiptari në Vjenë

Një 37-vjeçar shqiptar dhe një 32-vjeçar austriak janë arrestuar në Vjenë, pasi dyshohen për përfshirje në...



4 shqiptarë të arrestuar në Itali, dyshohet grabitën 40 banesa

Katër shqiptarë, të moshave 24 deri në 38 vjeç, janë arrestuar në Itali, pasi dyshohen se janë pjesë e një ...



Marta Kos kritikon ashpër Serbinë për Mlladičin: Nderuan një kriminel lufte!

Komisionarja evropiane për Zgjerimin, Marta Kos, përsëriti qëndrimin se pamjet nga varrimi i Ratko Mlladiqit, i dënuar për gjenoc...



Thaçi dhe të tjerët para verdiktit të Hagës/ Sa pushtet kishin krerët e UÇK-së



108 ditë rezistencë, protestuesit kërkojnë largimin e Ramës

Protesta kundër qeverisë dhe kryeministrit Edi Rama vijon edhe në ditën e 108-të, ndërsa qytetarët kanë nisur marshimin...



Atentati/ Gjykata e Lartë kthen për rigjykim çështjen e Ergys Kolaverit

Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për çështjen e Er...



Aksident në aksin Lezhë-Shkodër, 3 të plagosur

Tre persona kanë mbetur të plagosur në një aksident rrugor pranë kryqëzimit të Gocajve, përgjatë superstradës...


Me sytë katër



21:25

PAMJET/ Shqiptarët "pushtojnë" gjykatën e Hagës para vendimit për krerët e UÇK-së

Atmosfera para Gjykatës Speciale në Hagë është intensifikuar në orët e fundit, në prag të shpalljes së vendimi...



"O hajdut, o hajdut...", shihni si iu ikën protestuesve Taulant Balla (VIDEO)

28:44



PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane

28:36



Pamje të rënda/ Avokati amerikan i drejton armën ish-gruas së tij në restorant

11:43



PAMJET/ Shoferi ishte pa ndjenja, polici jashtë detyrës ndalon makinën

11:17

SPORT

→ Të tjerë artikuj



21:18

"Nuk rri më këtu": kush është JJ Gabriel, ylli 15-vjeçar i Manchester United që dëshiron të prishë kontratën



19:55

Plani i Real Madrid për ta bërë Mbappé të fitojë Topin e Artë: luhet jashtë fushe



19:50

Conte te Juventus, për të dale nga kriza: çfarë dihet për zërat që flasin për shkarkimin e teknikut Spalletti



15:12

City shënon, Ruben Dias
vrapon të festojë, por
kthehet menjëherë: iu
kujtua rregulli i vendosur



14:12

“Duhet të kesh turp”,
Kolarov shpërthen ndaj
arbitrit Pairetto:
zv/trajneri i Inter
përrjashtohet direkt



14:08

“Ju nuk e njihni”: Kaiki
mahnit me Parmën,
Fabregas i bën elozhe.
Kush është talenti i ri i
Comos



12:11

Gasperini parashikues, i
thonë në konferencë se
Interi po humbet 0-2:
përgjigjet “Sa është
ora?”

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.